Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Autoriteti kontraktor</b>	<b>Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës</b>	<b>Vlera e shpallur fituese</b>

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>4</sup>Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë:**

- Kandidati ofertues duhet të tregojë dhe vërtetojë se, në objektin e veprimtarisë së tij, është në gjendje të realizojë objektin e prokurimit.
- Sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” të kësaj shtojce (Shtojca 12).
- Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit, shoqëruar me dokumentacion që vërteton se nuk ka detyrime të pashlyera për taksat vendore pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet, si dhe sipas ekstraktit të regjistrimit të QKB, për vitin 2019, 2020. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të vërtetuara të pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë në çdo faqe të dokumentit, të shoqëruar me Raport të Ekspertit Kontabël. Nuk është e detyrueshme paraqitja e Raportit të Ekspertit Kontabël për ato subjekte, që nuk plotësojnë kushtet ligjore.
- Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit, duhet të mos jetë më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Për plotësimin e këtij kriteri,

operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në tender vërtetim të lëshuar nga organet tatimore, për xhiron vjetore gjatë tre viteve të fundit, sipas legjislacionit në fuqi.

### 3. *Kapaciteti teknik*

Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më pak se **50%** të vlerës së fondit limit që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Ose

- Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, të jetë jo më pak se 100% i vlerës së fondit limit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bënë ofertën të kualifikueshme.

Si referencë për llogaritjen e afateve, do të merret data e kolaudimit të objektit, konform akteve kligjore dhe nënligjore në fuqi.

Për plotësimin e kritereve të mësipërme për kualifikim, lidhur me punët e ngjashme, shoqëritë ofertuese duhet të paraqesin:

- Kontratën.
- Situacionin përfundimtar të punimeve.
- Aktin e kolaudimit të punimeve.
- Aktin e marrjesnëdorëzimit të punimeve ng investitori.
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës 8.

Për objektet me financime private, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- Lejendërtimi,
- Kontratën e Sipërmarrjes,
- Situacionin përfundimtar të objektit,
- Aktin e Kolaudimit përfundimtar të objektit,
- Formular Vlerësimi ng Investitoris sipas Shtojcës përkatëse,
- Faturën/at tatimore të shitjes.

Për objektet me vetëfinansim, Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- Lejendërtimi,
- Situacionin përfundimtar të objektit,
- Aktin e Kolaudimit përfundimtar të objektit,
- Faturën/at tatimore të shitjes.

#### **4. Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës që prokurohet.**

Ofertuesit pjesëmarrës, duhet të jenë të pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë dhe nivelet si më poshtë:

<b>N.P – 1 C</b>	Punime gërmimi në tokë.
<b>N.P – 5 C</b>	Punime nëntokesore, ura e vepra arti.
<b>N.P – 7 D</b>	Ujësjiellës, gazësjiellës, vajësjiellës, vepra kullimi e vaditje.
<b>N.P – 12 C</b>	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
<b>N.S – 4 B</b>	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, ...
<b>N.S – 18 B</b>	Punime topogjeodezike.
<b>N.S – 20 A</b>	Shpime gjeologjike-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Për operatorët ekonomikë të huaj, të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i tyre i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës, konform legjisllacionit Shqiptar.

**5.** Shoqëria ofertuese duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim, nga administratori i shoqërisë, ku të përcaktojë drejtuesin/t teknik të shoqërisë i cili do të jetë i pranishëm gjatë të gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Gjithashtu në këtë deklaratë administratori i shoqërisë duhet të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë për drejtuesin teknik. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

**6.** Ofertuesit pjesëmarrës duhet të paraqesin çertifikimet e mëposhtme, për të cilat operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- **EN-ISO 9001-2015** ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë), ose ekuivalente.
- **BS OHSAS 18001/2007 ose ISO 45001/2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose ekuivalente.
- **EN-ISO 14001-2015** (Sistemi i menaxhimit të mjedisit), ose ekuivalente.
- **ISO EN 3834-2:2006** “(Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike), ose ekuivalente.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- **DS CEN 15128** (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit), ose ekuivalente.
- **BS EN 13331-1 2002** ( Sistemet per veshjen e kanaleve), ose ekuivalente.
- **SA 8000:2014** ( Sistemi i menaxhimit të përgjegjësive shoqërore), ose ekuivalente.
- **ISO 1452-1:2009** (Sistemi i tubacioneve plastike), ose ekuivalente.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

7. Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë në tender deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë ofertuese që, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur është i saktë dhe nuk përmban të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi. Mos paraqitja e deklaratës në formën dhe mënyrën e kërkuar, përbën shkak për skualifikim. Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim dhe penalizim konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të tij të paktën 3 inxhinierë të çertifikuar për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, të cilët duhet të figurojnë në licensën e shoqërisë pjesëmarrëse dhe në listpagesa, shoqëruar edhe me çertifikatat që provojnë certifikimin e mësipërm dhe kontrata e punës noteriale.

9. Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive/pajisjeve, sipas shtojcës 10, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

Nr.	Lloji i makinerive	Disponimi/gjendja	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues mbi 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 9
2.	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	Copë 4
3.	Total Station	Në pronësi ose me qira	Copë 1
4.	Kamion vetëshkarkues nga 7.5 deri 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 4
5.	Kamionçina vetëshkarkuese deri në 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 7
6.	Sondë najloni	Në pronësi ose me qira	Copë 4
7.	Kamion vetëshkarkues nga 3.5 deri 9 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
8.	Autovinç	Në pronësi ose me qira	Copë 2
9.	Mini Eskavatorë	Në pronësi ose me qira	Copë 2
10.	Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 2
11.	Aparat Saldimi Tuba Celiku	Në pronësi ose me qira	Copë 1
12.	Kufizues Shpejtësie	Në pronësi ose me qira	Copë 1
13.	Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë2
14.	Asfalto shtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 1
15.	Rimorkiator për transportin e makinerive	Në pronësi ose me qira	Copë 2
16.	Eskavatorë me zinxhirë	Në pronësi ose me qira	Copë 5
17.	Tabela sigurie në punë	Në pronësi ose me qira	Copë 25
18.	Gazogjen	Në pronësi ose me qira	Copë 1

Dokumenta Standarde të Tenderit

19.	Fikse zjarri	Në pronësi ose me qira	Copë 5
20.	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Copë 5
21.	Prerëse Asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 1
22.	Skrep/fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	Copë 2
23.	Mini fadromë (Bobcat)	Në pronësi ose me qira	Copë 2
24.	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	Copë 4
25.	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 2
26.	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qira	Copë 2
27.	Sondë shpimi për materiale shkëmbore	Në pronësi ose me qira	Copë 1
28.	Betoniere	Në pronësi ose me qira	Copë 6
29.	Kokore pune, sigurie	Në pronësi ose me qira	Copë 180
30.	Prozhektorë ndriçues	Në pronësi ose me qira	Copë 3
31.	Aparat saldimi për tuba nën presion	Në pronësi ose me qira	Copë 1
32.	Aparat saldimi për tuba plastike	Në pronësi ose me qira	Copë 1
33.	Aparat kontrolli saldimi	Në pronësi ose me qira	Copë 2
34.	Sondë çeliku	Në pronësi ose me qira	Copë 1
35.	Fabrikë betoni shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore Kodi: III.1.B, lëshuar nga QKL ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.	Në pronësi ose qira ose kontratë noteriale furnizimi.	Copë 1
36.	Materiale ndërtimi/lloç, shoqëruar me çertifikatë ISO 9001:2015, të vlefshme.	Prodhuës ose tregtues ose kontratë furnizimi.	Copë 1
37.	Fabrikë asfalti shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore kodi III.1.B, lëshuar nga QKL ose leja mjedisore lëshuar nga Ministria e Mjedisit.	Në pronësi ose qira ose kontratë noteriale furnizimi	Copë 1
38.	Autobot prajmeri	Në pronësi ose me qira	Copë 1
39.	Nyje fraksionimi intertesh, shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore kodi III.1.A, lëshuar nga QKL, ose leja mjedisore lëshuar nga Ministria e Mjedisit.	Në pronësi ose qira ose kontratë noteriale furnizimi	Copë 1
40.	Aparat saldimi tuba plastike Fi 110-400	Në pronësi ose me qira	Copë 1
41.	Autobitumatrice/bot bitumi	Në pronësi ose me qira	Copë 1

Makineritë – pajisjet në pronësi duhet të vërtetohen dhe provohen me anë të aktit të pronësisë (kontrata e blerjes apo dhurimi, faturë çdoganimi, fatura tatimore përkatëse, etj). Ato të marra me qira të shoqërohen me kontratën e qirasë noteriale dhe aktin e pronësisë së qiradhënësit (kontrata e blerjes apo dhurimi, faturë çdoganimi, fatura tatimore përkatëse, etj), e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve. Makinerite e dhena me qera duhet të jenë me qera vetëm në një subjekt. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të tyre. Rastet e shkeljes së kesaj kerkese do të perbejnë kusht për skualifikim.

Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet: Leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjeteve, çertifikatë për transport dhe foto të mjeteve ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit. Në rastë se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i rregjistruar në një vend të huaj, atëherë mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjim të përkohshëm, e cila vërtetohet nëpermjet dokumentit hyrës dhe një deklaratë ku të jetë e shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive.

**10.**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë një numër mesatar prej **180 punonjës** për periudhën Nentor2020 – Janar 2021.Për të vërtetuar këtë pikë, ofertuesi të paraqesë vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ku të jetë specifikuar numri i punonjësve për secilin muaj, konform legjislacionit në fuqi.

**11.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesinë tender listëpagesat sipas legjislacionit në fuqi, për periudhën Nentor 2020 - Janar 2021. Shkeljet e akteve ligjore dhe nënligjore në deklarinimin e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve,do të jenë kusht për skualifikim.

**12.** Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori shoqërisë ku të deklarojë se të gjitha mjetet e sipërcituara nuk janë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti, deri në përfundimin e punimeve, sipas proceseve të punës.

**13.**Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese që, A.K rezervon të drejtën të kryejë nëçdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak (në rast verifikimi në fjalë do të hartohet një procesverbal që do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i AK dhe përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese). Në këtë deklaratë ofertuesi duhet të bëjë deklarinimin e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve, me qëllim verifikimin e tyre. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

**14.**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier / specialistë me kontratë pune të lidhur para noterit, për punonjësit si më poshtë:

- Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi, 2 të punësuar. Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë,çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente,si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- DrejtuesTeknikinxhinierhidroteknik, 2 të punësuar. Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente,si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

Drejtues Teknik inxhinier mekanik, 1 të punësuar. Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente,si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet/markshajder, 1 të punësuar. Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë,



çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- Drejtues Teknik inxhinier mjedisi, 1 të punësuar. Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- Drejtues Teknik inxhinier Ndërtimi në profilin Gjeoteknikë, 1 të punësuar. Për këtë pikë duhet të paraqiten kontratë individuale të punës me kohë të plotë të lidhur para noterit, diplomë, çertifikatë të lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

**15.** Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit, të paktën një inxhinier mjedisi, drejtues teknikë, i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë për ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor, si dhe të jetë i pajisur me licensë kodi III.2.A (1+2), si dhe të jetë i çertifikuar/kualifikuar si përgjegjës për dëmet mjedisore.

**16.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në tender grafikun e punimeve, i cili duhet të jetë në përputhje me zërat e punës dhe me afatin kohor e përcaktuar në dokumentet e tenderit.

**17.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në shoqëri një inxhinier, të çertifikuar si Ekspert privat zjarrëfikës, për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës, çertifikata, si dhe të figurojë në listpagesa dhe licensën e shoqërisë.

**18.** Operatori ekonomik ofertues në tender, së bashku me preventivin duhet të dorëzojë edhe analizat teknike për secilin çmim të preventivit të ofertës, bazuar kjo në VKM Nr.514, datë 15.8.2007 për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, pika 10. Ofertat për çmimet e përlllogaritura në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, do të refuzohen.

**19.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në shoqëri një inxhinier, të çertifikuar për dhënien e ndihmës së parë, për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës noteriale, çertifikata e ndihmës së parë të lëshuar nga institucionet/organet kompetente, si dhe të figurojë në listpagesa dhe licensën e shoqërisë.

**20.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit dhe të punësuar 1 Mjek, me kontratë individuale pune të lidhur para noterit, i cili të jetë i pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë.

**21.** Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, minimalisht punonjësit e mëposhtëm:

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Hidraulikë, minimalisht 8 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara.
- Specialist ndërtimi, minimalisht 3 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Muratorë, minimalisht 6 persona, për të cilët duhet të paraqiten e: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Karpentjerë, minimalisht 5 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Manovrator për makineritë e rënda, minimalisht 7 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe leje manovrimi.
- Elektracistë, minimalisht 5 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Hekurkthyes, minimalisht 3 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Teknikë ndërtimi, minimalisht 2 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës, diplomë dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Automakinistë, minimalisht 3 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontrate individuale të vlefshme të punës dhe leje manovrimi.
- Saldator, minimalisht 1 person, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Buldozerist, minimalisht 1 person, për të cilët duhet të paraqiten: Kontrate individuale të vlefshme të punës dhe leje manovrimi.
- Montator, minimalisht 1 person, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.
- Mekanikë, minimalisht 4 persona, për të cilët duhet të paraqiten: Kontratë individuale të vlefshme të punës, diplomë/çertifikatë dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente.

**22.** Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me licensë kodi III.1.B.

Licensë kodi I.2.A për masat e mbrojtjes ndaj zjarrit.

Licensë kodi III.1.A(1+2) për vlerësimin e ndkimit në mjedis.

Licensë kodi III.2.B për transportin e mbetjeve.

**23.** Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë të punësuar në shoqëri një inxhinier, të certifikuar si përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis, për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës, certifikata, si dhe të figurojë në listpagesa dhe licensën e shoqërisë.

**24.** Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë të punësuar në shoqëri, përveç drejtuesve teknike të mësipërm edhe një inxhinier mekanik dhe një inxhinier topograf për të cilin të paraqitet në tender kontrata e punës noteriale, diploma, si dhe të figurojë në listpagesa.

**25.** Me qëllim që operatorët ekonomik të njihen me terrenin ku do kryhen punimet ,autoritetikontraktordo tëorganizojënjëvizitënekantiernë datën 15.03.2021 ora 11:00 Nëpërfundimtëvizitësaautoritetikontraktor do tëpajisëoperatorëtekonomikëpjesëmarës me vërtetim, ku do tëvërtetohetpjesëmarja.

Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e **tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës)**, për të gjithë përmbajtjen e dokumentit, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë**tëcertifikuara “Apostille”**. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventen e Hagës, datë 5 tetor 1961, *“Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentëve zyrtare të huaja”*, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formëështë kusht skualifikues).

Mos paraqitja e deklaratave të kërkuara më sipër, përbën kusht për skualifikim.

Të gjithë drejtuesit teknikë, nuk duhet të jenë të punësuar në asnjë punë tjetër publike apo private, e cila sjell si pasojë penalizimin e shoqërisë ofertuese, konform parashkimeve të Vendimit nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar.

Në të gjitha rastet kur përdoret fjala markë ose emër, njihet njëvlefshmëria ose ekuivalente.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike tëMaterialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**Shtojca15**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
<Emri>

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 16**

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_



## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon në objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

